

**INSTITUTI CILËSOR PËR HULUMTIME, ANALIZA DHE TRAJNIME  
(iCHAT)**

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
dhe  
PASQYRAT FINANCIARE per vitin 2017

Prishtine ,Mars 2018

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3-4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE	6
PASQYRA E RRJEDHJES SËPARASË	7
NJOHJA ME ENTITETIN DHE SHPALOSJET E RAPORTIT TE SHPENZIMEVE	8-9
BAZA E PREGATITJES SE RAPORTEVE TE SHPENZIMEVE	10
PARAJA NË BANKË DHE PARAJA E GATSHME	11
SHPENZIMET E PERSONELIT	12
KAPITALI	12

## Raporti i auditorit te pavarur

**Menaxhmentit të : INSTITUTI CILËSOR PËR HULUMTIME, ANALIZA DHE TRAJNIME**  
(tutje referohet si "iCHAT")

### Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "INSTITUTI CILËSOR PËR HULUMTIME, ANALIZA DHE TRAJNIME - "iCHAT")" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar (Bilancin e Gjendjes) me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fonde dhe pasqyrën e rrjedhës të parasë për vitin që mbyllte me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose jepin pamjen e vërtetë dhe të drejtë) për, pozicionin financiar te INSTITUTI CILËSOR PËR HULUMTIME, ANALIZA DHE TRAJNIME - "iCHAT")" me datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që mbyllte në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosove, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin 04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, si dhe me Standardet Nderkombtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvèç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali

materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

**Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale**, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

**Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit** që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.

**Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.**

**Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë**, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Organizata të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Agron Mustafa, Auditor Ligjor

Nënskrimi /



Adresa: Rr. "Selim Berisha", Nr. 4, Bl. 0000 Prishtinë

Data: 29.03.2018

**Instituti Cilësor Për Hulumtime, Analiza Dhe Trajnine (iCHAT)**

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**

		<i><u>31 dhjetor 2017</u></i>	<i><u>31 dhjetor 2016</u></i>
		shënim <i>(në EUR)</i>	<i>(në EUR)</i>
<b>ASETET</b>			
Asetet jo - qarkulluese			
Prona dhe pajisjet	1	1.059.84	1.324,80
Totali i aseteve jo - qarkulluese		1.059.84	1.324,80
Asetet Qarkulluese			
Llogaritë e arkëtueshme			
Të arëtueshmet tjera			
Avanset			
Paratë në bankë dhe arkë	2	131.057,93	570,93
Totali i aseteve qarkulluese		131.057,93	570,93
Totali i aseteve		132.117,77	1.895,73
Detyrimet dhe Ekuiteti			
Detyrimet qarkulluese			
Llogaritë e pagueshme			
Të Hyrat e shtyra	3		570.93
Obligime ndaj donatoreve			
Totali i detyrimeve qarkulluese			570.93
Ekuiteti			
Kapitali	6	1.324.80	1.324.80
Net ( deficit)/suficit për vitin		130.792,97	
Totali ekuiteti		132,117.77	1.324.80
Totali i detyrimeve dhe i ekuitetit		132.117,77	1.895,73

Besmir Kokollari  
Drejtor Ekzekutive



Arbnesha Kastrati  
Drejtor Financiar

**Instituti Cilësor Për Hulumtime, Analiza Dhe Trajnine (iCHAT)**

**Pasqyra e të ardhurave**

	<b>31 Dhjetor</b>		<b>31 Dhjetor</b>
	<b>2017</b>		<b>2016</b>
	<b>Shënimi</b>	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga donacionet	<b>4</b>	<b>155.667,71</b>	<b>21.613,54</b>
Te hyrat tjera	4.1	3.509,09	
<b>Totali i të hyrave</b>		<b>159.176,80</b>	<b>21.613,54</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e pagave	<b>5</b>	15.564,70	12.642,47
Shpenzimet operative dhe projekteve	5.1	12.554.17	8.639.87
Shpenzimet e zhvlersimit	5.2	264.96	331.20
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>28.383.83</b>	<b>21.613.54</b>
<b>Teprica e të hyrave mbi shpenzimet për vitin</b>		<b>*130,792.97</b>	<b>0.00</b>

**Instituti Cilësor Për Hulumtime, Analiza Dhe Trajnine (iCHAT)**  
**Pasqyra e rrjedhës së parasë**

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
<b>Rrjedha e parasë se gatshme nga aktivitetet operative</b> (Mungesa)/teprica për vitin		
Përshtatja për:		
Zhvlerësimi	264.96	331.20
Ndryshimet në të arkëtueshme		
Ndryshimet ne avanse		
Ndryshimet në të pagueshmet	116.179,58	570,93
Ndryshimet në të pagueshmet tjera	14.878,35	
Ndryshimi në të ardhurat e shtyera		
Ndryshimet ne obligimet ndaj donatoreve		
<b>Neto paratë e gatshme nga aktivitetet operative</b>	<b>131.322,89</b>	<b>902,13</b>
<b>Rrjedha e parave nga aktivitetet e investimeve</b>		
Blerja e pronave dhe pajisjeve	(264.96)	(331.20)
<b>Neto paratë e gatshme të përdorura për aktivitetet</b>		
Investuese	<b>(131.057,93)</b>	<b>(570,93)</b>
<b>Neto rritja në para të gatshme dhe ekuivalentet e saj</b>	<b>131.057,93</b>	<b>570,93</b>
Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar		
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31		
<b>Dhjetor</b>	<b>131.057,93</b>	<b>570,93</b>

## 1. NJOHJA ME ENTITETIN DHE SHPALOSJET E RAPORTIT TE SHPENZIMEVE

Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnine "iCHAT" është një organizatë joftimprurëse i themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, që nga 25.05.2017 iCHAT ka Statusin e Përfitimit Publik me numer të regjistrimit 5115285-9 dhe numer fiskal 601207659. Organizata është themeluar me qëllim të:

- a) Hulumtimit dhe analizave të pavarura të politikave publike në lëmin e qeverisjes demokratike si dhe hulumtime dhe analiza të shëndosha profesionale me paanshmëri të plotë të çështjeve vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.
- b) Fuqizimit të rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejta të pakicave) - që jetojnë në Kosovë duke i përkrahur, duke i promovuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që të jenë qytetarë të barabartë në Kosovë dhe njëherit duke qenë zë i fuqishëm i tyre për mundësi të barabarta për të gjithë komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Për t'i përbushur qëllimet iCHAT është fokusuar në këto fushëveprimtari: Hulumtime dhe Analiza, Konsulenca, Fuqizimi i rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejta të pakicave), Avokim dhe Lobim, Të Drejta të Njeriut, Organizimi i kurseve për edukim dhe trajnim. Për të operuar në mënyrë profesionale dhe transparente Kuvendi i Anëtarëve i iCHAT ka nxjerrë rregullore të brendëshme të cilat janë në harmoni me ligjet në Kosovë, si:

1. Rregulloren për përgjegjësi disciplonore dhe mirësjellje në iCHAT
2. Rregulloren e brendëshme financiare
3. Politikat e Prokurimit
4. Politikat e burimeve njerëzore.

iCHAT i fillon iniciativat duke kryer një rishikim të gjerë të literaturës ekzistuese lidhur me temën që ka përgjedhur. Diskutimet e ekipit çojnë në krijimin e planeve hulumtuese. Metodat tona kërkimore përfshijnë intervistimin, analizat tekstuale, fokus grupet dhe raste studimore. iCHAT përdor një mori të burimeve të të dhënave, duke përfshirë edhe zyrtarët përkatës të zgjedhur, nëpunësit publikë, bizneset, organizatat joqeveritare dhe qytetarët në përpjekje për të kuptuar të gjithë fotografinë e një vendi të caktuar ose lidhur me një çështje të caktuar.

Me të dhënat e mbledhura hartohet një koleksion i materialevë që më vonë analizohet nga anëtarët e ekipit të iCHAT në drejtim të identifikimit të trendeve kryesore. Anëtarët e ekipit të iCHAT bashkëpunojnë për të shkruar pjesë të raporteve. Çdo anëtar i ekipit sjell një sfond të veçantë dhe njohuri për procesin e hartimit. Draft raportet gjithashtu shqyrtohen dhe rishikohen shumë herë nga ekipi i iCHAT.

iCHAT pastaj organizon një ngjarje për publikimit e raportit. Të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim, si dhe aktorë të tjera kyç dhe partnerët ftohen për të shqyrtuar dhe diskutuar gjetjet. iCHAT gjithmonë kërkon të sigurojë pjesëmarrjen e vendimmarrësve kryesorë në drejtim të avokimit për rekomandimet politike. Zakonisht, aktivitet, gjetjet dhe rekomandimet, tryezat e rrumbullakëta, diskutimet publike, të dhënat e shpërndara në hapësira publike, mbulohen nga mediet. Ndërsa materialet e tjera për marrëdhënien me publikun, publikohen përmes teknologjive të komunikimit si: web page, faqja në Facebook dhe llogaria Twitter, LinkedIn.

iCHAT pastaj kryen avokimin për rekomandimet e hulumtimit përmes takimeve me vendimmarrësit dhe përdorimin e medias. Përveç kësaj, iCHAT avokon për ndryshime të politikave (ku nevojiten) nga takimi me deputetë të ndryshme dhe grupet parlamentare. iCHAT monitoron gjatë gjithë kohës nëse janë zbatuar rekomandimet e tij. Instituti iCHAT tani merr pjes në mbledhjen e shtatë Komisioneve parlamentare si: Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport; Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korruptionit; Komisioni për Integrime Evropiane; Komisioni për Punë të Jashtme; Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike; Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petitione.

## Misioni

Institutit Cilësor për Hulumtime Analiza dhe Trajnine "iCHAT" është për të çuar më tej mirëqenien e qytetarëve të Kosovës përmes hulumtimeve empirike, analizave, trajnimeve dhe konsulencave, inicimin për informimin e mirë të politikave publike, ndërgjegjësimit, të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, të drejta të pakicave, avokimit dhe rrjeteve.

Të ofrojmë nxitje dhe veprimtari të vlefshme për krijimin e nismave dhe politikave efektive, ide dhe aksione konkrete për të mundësuar një reagim të integruar të shtetit, shoqërisë civile dhe komunitetit ndaj veprimeve negative dhe të atyre që nxisin për veprime të tilla. Objktivi është që ta adresojmë këtë veprim në mënyrë efektive dhe dinamike në katër fushat bazë të përballimit të problemit, në zbatimin e ligjit, parandalimin, trajtimin e zvogëlimin e dëmit dhe edukimin.

iCHAT është duke implementuar projektin "Riintegrimi i qëndrueshëm i të rikthyerve dhe parandalimin e migrimit të qytetarëve në Pejë, Skenderaj dhe Drenas", i cili mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH bazuar në kontratën Nr. 81219157 nënshkruar me 16 nëntor, 2017. I cili implementohet nga 1.12.2017 deri me 31.08.2018. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë qëndrueshmërinë socio-ekonomike të personave të riathesuar dhe parandalimin e migrimit ilegal për qytetarët në Pejë, Skenderaj dhe Drenas, me fokus në komunitetet minoritare (Boshnjak dhe komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas) përmes ngritjes së vetëdijes dhe ngritjes së kapaciteteve për punësim. Pjesa e trajnimeve të projektit është fokusuar në fushat dhe sektorët me potenciale më të larta biznesi dhe mundësi punësimi dhe në këtë mënyrë, aktivitetet e projektit janë dizajnuar që të rezultojnë me rezultate të qëndrueshme.

## 2. BAZA E PREGATITJES SE RAPORTEVE TE SHPENZIMEVE

### 2.1. Konventa e Kontabilitetit

Raporetet e shpenzimevee dhe përdorimi i fondeve ("Raportet") janë përgatitur në pajtim me hyrjet në arkë dhe në bakë dhe pagesat e bëra. Mbi këtë bazë të ardhurat dhe shpenzimet njihen në momentin e pranimit te chash-it respektivisht daljes se cash-it.

### 2.2. Valuta në të cilën raportohet

Raportet e shpenzimeve janë përgatitur në valutën Evropiane (EUR). OJQ "iCHAT" në shenimet dhe raportet e saj ka prezantuar transaksione ne të nje valute; Euro.

Pershkrimi	Vlera e mjeteve-financimi i projektit (në EUR)	Data e pranimi te mjeteve per projekt (në EUR)
Donacionet në para të gatshme - Donatori GIZ	136.580,00	07.12.2017
Donacionet në para të gatshme - MASHT	2.020,15	02.06.2017
Donacionet në para të gatshme - Ministria e Kultures Rinis dhe Sporit	1.990,00	08.05.2017
Donacionet në para të gatshme - ATRC	13.147,64	03.07.2017, 15.05.2017 13.02.2017, 16.01.2017, 08.03.2017, 13.04.2017 Xh.II.
Donacionet në para të gatshme - KIMUN MKRS - OSCE	850.00 1.079,92	XK051117008880000144 18.12.2017

GJITHSEJTË FONDET NGA  
DONATORET

155.667,71

### 1. PAJISJET

Pershkrimi	Vlera e 31.12.2017 (në EUR)	Vlera e 31.12.2016 (në EUR)
KOMPJUTERAT	800.00	
TAVOLINA	234.00	
KARRIKE	290.80	
Amortizimi 20%	-264.96	
<b>GJITHSEJ PAJISJE NETO</b>	<b>1,059.84</b>	<b>1.324.80</b>

## 2. PARAJA NË BANKË DHE PARAJA E GATSHME

	Gjendja e mjeteve 31.12.2017 (në EUR)	Gjendja e mjeteve 31.12.2016 (në EUR)
Paraja në Bankë	131.057,93	570.93
Paraja evogel ne arke		
<b>GJITHSEJTË PARAJA NË BANKË DHE PARAJA E GATSHME</b>	<b>131.057,93</b>	<b>570.93</b>

## 3. TE HYRAT E SHTYRA

Me 31.Dhjetor 2017 nuk ka te hyra te shtyra.

## 4. TE HYRAT NGA DONACIONET

Pershkrimi	Vlera e mjeteve- financimi i projektit (në EUR)	Data e pranimi te mjeteve per projekt (në EUR)
Donacionet në para të gatshme - Donatori GIZ	136.580,00	07.12.2017
Donacionet në para të gatshme - MASHT	2.020,15	02.06.2017
Donacionet në para të gatshme - Ministria e Kultures Rinis dhe Sporit	1.990,00	08.05.2017
Donacionet në para të gatshme - ATRC	13.147,64	03.07.2017, 15.05.2017 13.02.2017, 16.01.2017, 08.03.2017, 13.04.2017
Donacionet në para të gatshme - KIMUN	850,00	Xh.ll.
MKRS - OSCE	1.079,92	XK051117008880000144 18.12.2017

## GJITHSEJ FONDET NGA DONATORET

155.667,71

## 5. SHPENZIMET

### SHPENZIMET E PERSONELIT

Pershkrimi	Vlera e shpenzimeve te personelit 31.12.2017 (në EUR)	Vlera e shpenzimeve te personelit 31.12.2016 (në EUR)
Paga neto	13.516,97	11.581,49
Kontributi pensional	691,25	442,26

Tatimi në paga dhe kontributi penz.	1.556,48	618,72
<b>GJITHSEJTË SHPENZ. E PËRSONELIT</b>	<b>15.564,70</b>	<b>12.642,47</b>

Tatimet dhe kontributet pensionale janë paguar konform rregulloreve te aplikueshme ne Kosovë

#### 5.1 SHPENZIMET TJERA

Shpenzimet operative dhe projekteve	12.554.17	8.639.87
-------------------------------------	-----------	----------

#### GJITHSEJTË SHPENZIMET TJERA

**12.554.17**

**8.639.87**

#### 5.2 SHPENZIMET E ZHVLERSIMIT

Shpenzimet e zhvleresimit	264.96	331.20
---------------------------	--------	--------

#### GJITHSEJ SHPENZIMET ZHVLERSIMIT

**264.96**

**331.20**

#### 6 KAPITALI

Ne fund te periudhe ekuiteti eshte: 132,117.77 euro